



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:078437
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05471973

C.nr.1874/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve – propozuesve të masës së sigurisë, N. S., L. L., M. T., F. M., ., që të gjithë nga . kundër të paditurës – kundërpropozueses së masës së sigurisë, D. e U. – K. e Gj. me seli në Gj., me objekt kontesti, padi për kompensim dëmi me propozim për masë të sigurisë, pas mbajtjes së seancës gjyqësore më datën 18.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr propozimi për masë të sigurisë e paditësve – propozuesve të masës së sigurisë N. . L. L., M. T., F. M., . që të gjithë nga Gj., kundër të paditurës – kundërpropozueses së masës së sigurisë, Dr. e U. – K. e Gj. me seli në Gj., me objekt kontesti, padi për kompensim dëmi me propozim për masë të sigurisë.

A r s y e t i m

Paditësit – propozuesit e masës së sigurisë, N. S., L. L., ., që të gjithë nga Gj., në këtë gjykatë më datë 14.09.2020 ka paraqitur padi ndaj të paditurës – kundërpropozueses së masës së sigurisë, D. e U. – Komuna e . me objekt kontesti padi për kompensimin e dëmit me propozim për caktimin e masës së sigurisë.

Lidhur me këtë çështje, kjo gjykatë më datën 18.03.2024 ka caktuar shqyrtimin gjyqësor, ku palët ndërgjygjëse gjegjësisht paditësit- propozuesit dhe e paditura – kundërpropozuesja edhe pse e kanë pranuar ftesën në mënyrë të rregullt për seancë më datë 09.02.2024 përmes aktvendimit procedural, nuk kanë prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata duke e pasur parasysh se pala paditëse dhe ajo e paditur ka munguar në seancën dëgjimore edhe pse kanë qenë e ftuar në mënyrë të rregullt përmes aktvendimit procedural, për datën dhe orën e cekur si më lartë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, duke u bazuar në dispozitën e nenit 409 paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ku përcaktohet se “*Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.*”, gjykata e konsideroj të tërhequr padinë e paditësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2024:078437
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05471973

Nga të lartcekurat, e konform nenit 409 paragrafi 1, të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK-së), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1874/2020, datë 18.03.2024

Gjyqtarja,
Florije Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate.